



Prishtinë, 29/4/2024

Komisioni i Garave të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), në bazë të kompetencave të dhëna me aktet normative të FBK-së, nën suaza të mandatit që ushtron, në mbledhjen e mbajtur me datë 29.04.2024, në përbërje prej: Armend Hamiti kryetar i KG, Arben Polloshka anëtar i KG dhe Arianit Shala anëtar i KG shqyrtoi dhe miratoi këtë:

VENDIM NR. 07/2024 I KOMISIONIT TË GARAVE

- I. Komisioni i Garave ka shqyrtuar ankesën e paraqitur nga Vëzhguesi i ndeshjes së Ligës së Dytë Meshkujt, Play Off – Finale ndeshja II-të, e zhvilluar me datë 03/04/ 2024 mes KB Grapeland dhe KB KEKU (sjellja e lojtarit Gent Shala drejt gjyqtarit Arian Kera).
- II. **Komisioni i Garave** më 12 Prill 2024 në zyrat e FBK-së, me qëllim sqarimin e situatës në fjalë e si pasojë e mungesës së informatave të nevojshme dhe video incizimit për shqiptimin e masave adekuate ka mbajtur mbledhje ku janë marr sqarimet e nevojshme nga Mehdi Gashi (vëzhgues), Arian Kera (gjyqtari i ndeshjes ndaj të cilit supozohet se është kryer sulmi), Xhelal Mumini (gjyqtari kryesor i ndeshjes).
- III. Komisioni i Garave merr Vendim që ndaj Gent Shala lojtar i KB Grapeland të iniciohet procedura disiplinore në pajtim me nenin 52.17 të Propozicioneve të Garave për Kategoritë Seniore Edicioni 2023/2024.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:





ARSYETIM

Gjatë vendimmarrjes lidhur Vendimin Nr. 07/2024, Komisioni i Garave ka marrë parasysh faktet në vijim:

- (a) Deklaratat e Mehdi Gashi (vëzhgues), Arian Kera (gjyqtari i ndeshjes ndaj të cilit supozohet se është kryer sulmi), Xhelal Mumini (gjyqtari kryesor i ndeshjes).
- (b) Nga kjo mbledhje u murr informata se i njëjti lojtar ka pasur sjellje te pahijshme edhe në lojën Ligës së Dytë Meshkujt, Play Off – GjysemFinale ndeshja I-rë, e zhvilluar me datë 21/03/ 2024 mes KB Grapeland dhe KB Gjakova dhe ka tentuar një tentim sulmi ndaj gjyqtarit Ilir Shala por që është menaxhuar pa pasoja.
- (c) Komisioni i Garave morri vendim që ndaj Gent Shala lojtar i KB Grapeland në përputhje me nenin 52.17 të Propozicioneve të Garave për Kategoritë Seniore Edicioni 2023/2024 të iniciohet procedure disiplinore.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës
+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr. 83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

Në emër të Komisionit të Garave të FBK-së,

Armend **HAMITI**
Kryetar i Komisionit



Federata e Basketbollit të Kosovës

KËSHILLË JURIDIKE:

Në pajtim me nenin 45 të Propozicioneve të Garave për Kategoritë Seniore, Edicioni 2023/2024, në vendimin e Komisionit të Garave është e lejuar ankesa tek Komisioni i Arbitrazhit të FBK-së (si organ i shkallës së dytë), e cila dorëzohet më së voni 24 orë pas marrjes së vendimit. Për ankesë, paraqitësi i ankesës duhet të deponojë në llogarinë e FBK-së shumën prej 500.00 €.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:

